



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr 838 Prot

Gjirokastrë më 05 : 02 :2024

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 31.01 .2024

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.01 .2024.

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në 31.01 .2024 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:15.

Marrin pjesë në mbledhje 22 anëtarë dhe i bashkohen mbledhjes Spartak Drasa, Adrian Novi dhe Fatjona Basha. Z. Dashnor Qeli, i cili është online. Gjithsej 25 anëtarë.

Mungojnë në mbledhje; Aliko, Qeli, Binozi, Feruni, Guçe, Shehaj, Pandos.

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes. Online merr pjesë Ardita Koçollari.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 14. 12.2023. dhe mbledhjes jashte 29.12.2023.

2.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.01. 2024”.

3.P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01-31.01. 2024”.

4.P/ Vendim “Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit të buxhetit vendor, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit për vitin 2024”.

5.P/Vendim “Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit”

6.P/Vendim “Miratimin e vlerës si dhe të listës së 20 përfituesve për programin e subvencionit të qirasë nga fondet e buxhetit të shtetit në vlerën 2.112.000lekë/vit dhe 908.400 lekë/vit nga bashkia Gjirokastrë.

7.P/Vendim “Për miratimin e listës së parcelave kullimore verore/dimërore që do të kontraktohen për përdorim me qira për kullotje për sezonin veror 2024 dhe sezonin dimëror 2024-2025”.

8.P/Vendim “Për miratimin e dhënies së sipërfaqeve të tokave bujqësore dhe kullimore me qira”.

9.P/Vendim “Për miratimin e raportit të Ardhurave Afatmesme 2025-2027 në bashkinë Gjirokastrë”

10.Të ndryshme.

Miratohen me 23 vota pro pikat 4, 5 dhe 6

4.P/ Vendim "Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit të buxhetit vendor, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit për vitin 2024".

5.P/Vendim "Për miratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6%, për familjet dhe individët në nevojë që rezultojnë me pikë të pamjaftueshme nga sistemi i pikëzimit"

6.P/Vendim "Miratimin e vlerës si dhe të listës së 20 përfituesve për programin e subvencionit të qirasë nga fondet e buxhetit të shtetit në vlerën 2.112.000lekë/vit dhe 908.400 lekë/vit nga bashkia Gjirokastër.

ZNJ. Isaraj : paraqet para këshilltarëve kërkesën e fshatit Plesat për ndërhyrje në rrugën e fshatit dhe për rrethimin e varrezave.

I është deleguar drejtorisë përgjegjëse në bashki për hartimin e projektit për ndërhyrje.

Kalohet te pika të ndryshme:

z. Brahim: Duhet kujdes me punimet që bëhen, sepse investimi të Pallati I Sportit duhet të ketë kujdes në emër të transparencës për afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve.Gjithashtu të merren masat se në mes të fshatit Valare gjenden kavaleta me pleh kafshësh.

Për personat në azile,pse sillni kërkesa kur nuk ka vende?

Z. Nebiaj: Përsa i përket njoftimit të punimeve nuk është rasti I parë që firmat kërkojnë shtyrje të punëve.Tabela te kisha e ka njoftimin.

Z. Drasa: Jam dakord me propozimin e Petritit , sepse në sjellim këtu shqetësimin e qytetarëve .

Znj . Cacaj shpreh problemin e transportit urban në lagjen " Dunavat" dhe problemin e lëvizjes së nx të gjimnazit në orën 7:30. Të shikohet për vendosjen e linjave egzistuese.

Sqaron z. Nebiaj. Ky problem është provizor për shkak të uljes që ka bërë rruga dhe po kryejmë ndërhyrje.

Mbyllet mbledhja në orë 13: 00 nga znj Isaraj.

**Sekretar i Këshillit**  
**Etleva Yzo**



**Kryetar i Këshillit**  
**Merita Isaraj**

